

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY	 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.43/2018	Data: 30.04.2018

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 58 pika h). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dhe nenit 6 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunimin Nder komunal dhe nenit 5 paragrafi 1.1 dhe Rregullores Nr.09/2013 për ngritjen e Bashkëpunimit Nder komunal, në mbledhjen e mbajtur me 30.04.2018, shqyrtoi Propozim-Vendimin për Nismën për bashkëpunim Nder komunal me Komunat në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe mori:

VENDIM

PËR INICIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL ME KOMUNAT NË FUSHË E ZVOGËLIMIT TË RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË

1. Bashkëpunimi nder komunal do të zhvillohet me komunat si më poshtë:
 1. Komuna e Pejës
 2. Komuna e Malishevës dhe
 3. Komuna e Klinës
1. Qëllimi i bashkëpunimit - është për të ngritur rritjen për forcimin e aftësive ripërtëritëse urbane nga fatkeqësitë, duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushën e ngritjes dhe shkëmbimit të përvojave për projektet me interes të përbashkët, promovimin e kuptimit të rreziqeve urbane dhe ndërkomunale si dhe ngritjen e vetëdijes publike për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë.
Bashkëpunimi do të filloi si pilot-projekt në kuadër të Projektit Rajonal të UNDP-së " Ngritja e rrjetit për forcimin e aftësive ripërtëritëse urbane nga fatkeqësitë në Evropën Juglindore " si dhe pjesëmarrja në projektet e kësaj natyre që i ofron Bashkimi Evropian.
2. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti, përfitimit të shumanshëm dhe të përbashkët në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.
3. Bashkëpunimi iniciohet për të zbatuar aktivitete të përbashkëta me Projektin Rajonal të UNDP-së "Ngritja e rrjetit për forcimin e aftësive ripërtëritëse urbane nga fatkeqësitë në Evropën Juglindore " si dhe projekte të kësaj natyre që i ofron Bashkimi Evropian.
4. Projekti ka për objektiv parandalimin e ndikimeve serioze të fatkeqësive urbane në njerëz, në të mira materiale dhe mjedis. Synohet të bëhet përmes shkëmbimit të modeleve rajonale me të mira të bashkëpunimit në

nivel komunal për zvogëlim të rreziqeve nga fatkeqësitë. Kjo përfshin edhe ngritjen e kapaciteteve në nivel lokal dhe rajonal, promovimi i kuptimit të rreziqeve të përbashkëta urbane dhe ndërkomunale si dhe ngritja e vetëdijes publike për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

5. Bashkëpunimi ndërkomunal do të mundësojë përfitime të drejtpërdrejta për të zhvilluar projekte në fushën e parandalimit nga fatkeqësitë.
6. Bashkëpunimi i suksesshëm ndërkomunal do të mundësojë përfitime të drejtpërdrejta për realizimin e projekteve të përbashkëta në të ardhmen dhe këmbimin e pajisjeve nga komunat reciproke.
7. Kuvendi i Komunës autorizon Kryetarin e Komunës që të përfaqësojë Komunën gjatë bisedimeve për arritjen e marrëveshjeve për bashkëpunim ndërkomunal.
8. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tij në ueb fagen e komunës.
9. Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës, dhe një kopje në arkivin e Kuvendi të Komunës.



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT - OPSTINA ISTOK
DIREKTORIA E ADMINISTRATES PERGJITHSHVE
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE

Adresa: Istok

01-039-4/07-05.2018

B

15.05.2018



KRYESUESI I KUVENDIT,

Z. Qarush Balaj

Qarush Balaj

